



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:201107

Datë: 15.11.2022

Numri i dokumentit: 03647677

C.nr.1015 /2022

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarës Mirvete Alidema dhe bashkëpunëtoren profesionale Valbona Abdyli, në çështjen kontestimore të paditëses K...R.. i K.. Sh.p.k (KRK) –Prishtinë , Zyra Qendrore “ B.D.” nr. ..., kundër të paditurit Q.M dhe F.M, nga fshati V..., Komuna e Gj..., me objekt kontesti kompensim dëmi, jashtë seancës, me datë 15 Nëntor 2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET Marrëveshja për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar e arritur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Gjilan, me numër të referencës Nd.nr.96/2022, e arritur në gjykatë më datë 15.11.2022, në çështjen kontestimore sipas numrit C.nr.1015/2022, të paditëses KRK-Sh.p.k e ushtruar ndaj të paditurve Q.M. nga fshati V..., Komuna e Gj..., për shkak të kompensimit të dëmit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja, në këtë gjykatë ka paraqitur padi më datën 30.09.2022, kundër të paditurëve Q. M dhe F.M që të dy nga fshati V... Komuna e Gj..., për shkak të kompensimit të dëmit.

Bazuar në natyrën e kontestit kjo gjykatë ka vlerësuar se kjo lëndë mund të jetë e përshtatshme për tu referuar në procedurën e ndërmjetësimit, andaj në pajtim me nenin 8 të Ligjit Për Ndërmjetësimin Nr.06/L-009, me datën 31.10.2022, këtë çështje kontestimore, gjykata e ka referuar në Qendrën e Ndërmjetësimit.

Qendra e Ndërmjetësimit në kuadër të Gjykatës Themelore në Gjilan me datë 15.11.2022, kësaj gjykate i ka dërguar Marrëveshjen për Zgjidhjen e Ndërmjetësuar në mes palëve ndërgjyqëse me numër të referencës Nd.96/2022, të datës 15.11.2022 për aprovim.

Gjykata konstaton faktin se rasti i zgjidhur me ndërmjetësim, i plotëson kushtet ligjore për tu aprovuar nga gjykata, pasi që palët lirish mund të disponojnë me të drejtat për të cilat janë marrë vesh në zgjidhjen e rastit.

Lidhur me shpenzimet gjykata vendosi bazuar në nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësim.

Nga të cekurat më lartë e në mbështetje të nenit 8 paragrafi 1 dhe 2, neni 15 paragrafi 1 dhe neni 19 paragrafi 1 të Ligjit Për Ndërmjetësim si dhe në pajtim me nenin 3 paragrafi 3 të LPK-ës, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr.1015/2022, me datë 15.11.2022

Gjyqtarja,
Mirvete Alidema

UDHËZIM JURIDIK: kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.